FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 83

Tiranë – E martë, 1 qershor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 51/2021, datë 4.5.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 22.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, 'Për buxhetin e vitit 2021', të ndryshuar".....	8593
Ligj nr. 52/2021, datë 4.5.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 22.3.2021, "Për miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar 'Keymen Ilac Sanayi ve Ticaret' AS, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 *(Vero Cell)* Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës".....	8593
Ligj nr. 53/2021, datë 4.5.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 10, datë 24.3.2021, "Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar 'Keymen Ilac Sanayi ve Ticaret' AS, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (*Vero Cell*) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës".....	8594
Ligj nr. 54/2021, datë 4.5.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 11, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, 'Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë', të ndryshuar".....	8594
Ligj nr. 55/2021, datë 4.5.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 12, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, 'Për regjistrin e pronarëve përfitues'".....	8594
Ligj nr. 56/2021, datë 4.5.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 13, datë 31.3.2021, "Për një ndryshim në ligjin nr. 8688, datë 23.10.2000, 'Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit', të ndryshuar".....	8595

Vendim i Kuvendit nr. 51/2021, datë 27.5.2021	Për emërimin e zotit Kreshnik Ternova anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik.....	8595
Vendim i Kuvendit nr. 52/2021, datë 27.5.2021	Për emërimin e zotit Fiorent Zguro anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik.....	8595
Vendim i Kuvendit nr. 53/2021, datë 27.5.2021	Për emërimin e zonjës Anila Malaj anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik.....	8596
Rezolutë e Kuvendit datë 27.5.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për vitin 2020.....	8596
Rezolutë e Kuvendit datë 27.5.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave, për vitin 2020.....	8598
Rezolutë e Kuvendit datë 27.5.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2020.....	8599
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 214, datë 26.5.2021	Për miratimin e formës standarde të akteve të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.....	8601
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 215, datë 26.5.2021	Për miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.....	8627
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 4.5.2021	Mbi kërkesën e shoqërisë "WTS – Energji" sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.7.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, modifikuar me vendimin e ERE-s nr. 26, datë 9.4.2009 dhe vendimin nr. 115, datë 7.10.2013.....	8633
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 4.5.2021	Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.1.2021.....	8634
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4472, datë 28.5.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtim rruge, unazë (ish-Kundërajrori)", Korçë.....	8635

LIGJ
Nr. 51/2021

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 8, DATË 22.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 137/2020, 'PËR BUXHETIN E VITIT 2021', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 22.3.2021, i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, 'Për buxhetin e vitit 2021', të ndryshuar".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.5.2021.

LIGJ
Nr. 52/2021

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 9, DATË 22.3.2021, "PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR 'KEYMEN ILAC SANAYI VE TICARET' AS, PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN E INAKTIVIZUAR KUNDËR COVID-19 (*VERO CELL*) CORONAVAC, TË KRIJUAR NGA SINOVAC LIFE SCIENCE CO, LTD DHE TË PRODHUAR NË REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 22.3.2021, "Për miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar 'Keymen Ilac Sanayi ve Ticaret' AS, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (*Vero Cell*) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.5.2021.

LIGJ
Nr. 53/2021

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 10, DATË 24.3.2021, "PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR 'KEYMEN ILAC SANAYI VE TICARET' AS, PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN E INAKTIVIZUAR KUNDËR COVID-19 (*VERO CELL*) CORONAVAC, TË KRIJUAR NGA SINOVAC LIFE SCIENCE CO, LTD DHE TË PRODHUAR NË REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 10, datë 24.3.2021, "Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar 'Keymen Ilac Sanayi ve Ticaret' AS, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (*Vero Cell*) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.5.2021.

LIGJ
Nr. 54/2021

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 11, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002, 'PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 11, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, 'Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë', të ndryshuar".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.5.2021.

LIGJ
Nr. 55/2021

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 12, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 112/2020, 'PËR REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES'"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 12, datë 25.3.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, 'Për regjistrin e pronarëve përfitues"'.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.5.2021.

LIGJ
Nr. 56/2021

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 13, DATË 31.3.2021, "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8688, DATË 23.10.2000, 'PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 13, datë 31.3.2021, "Për një ndryshim në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, 'Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit', të ndryshuar".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.5.2021.

VENDIM
Nr. 51/2021

PËR EMËRIMIN E ZOTIT KRESHNIK TERNOVA ANËTAR I KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 25, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Kreshnik Ternova emërohet anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim i fillon efektet në datën 29.6.2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 27.5.2021.

VENDIM
Nr. 52/2021

PËR EMËRIMIN E ZOTIT FIORENT ZGURO ANËTAR I KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 25, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Fiorent Zguro emërohet anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim i fillon efektet në datën 29.6.2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 27.5.2021.

VENDIM
Nr. 53/2021

PËR EMËRIMIN E ZONJËS ANILA MALAJ ANËTARE E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 25, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Anila Malaj emërohet anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim i fillon efektet në datën 29.6.2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 27.5.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar kontributin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje;

Duke njohur misionin e Autoritetit për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv, që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2020, në drejtim të:

- Masave të marra për minimizimin e efekteve negative të pandemisë COVID-19 në tregjet e mbikëqyrura, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të treguesve të likuiditetit të shoqërive të sigurimit duke kërkuar pezullimin e shpërndarjes së dividentit dhe zbatimin e një qasje të kujdesshme për shpërblimet e stafit, përditësimin e planeve të vazhdimësisë së veprimtarisë dhe planeve për përballimin e krizës, rritjen e frekuencës së raportimit të flukseve të shlyerjeve neto nga dyjavore në ditore për shoqëritë administruese të fondeve, etj.;

- Mbikëqyrjes përgjatë vitit 2020 të procesit të pagesave të dëmshpërblimit si pasojë e ngjarjeve të tërmetit të vitit 2019, si dhe bashkëpunimin me shoqëritë e sigurimit, me qëllim nxitjen dhe ndërmarrjen e iniciativave në funksion të zgjerimit të mbulimit të sigurimit të pronës;

- Përmirësimit të aspekteve të funksionimit dhe rregullimit të tregjeve të kapitalit dhe të fondeve të investimeve dhe fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet plotësimit dhe përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator;

- Angazhimit dhe kontributit të dhënë për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të adresuara në raportin e MONEYVAL-it jo vetëm nëpërmjet plotësimit të kuadrit rregullator ose nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, por edhe nëpërmjet realizimit të 20 inspektimeve të dedikuara për verifikimin e zbatimit të dispozitave ligjore për sa u përket sanksioneve ndërkombëtare në këtë fushë;

- Marrjes së 20 vendimeve për vendosjen e masave administrative dhe korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura në tregun e sigurimeve dhe tregun e titujve, përfshirë edhe revokimin e licencës për një shoqëri brokerimi dhe 6 vlerësues të pavarur në sigurime, si dhe broker e këshilltar investimesh në tregun e titujve;

- Verifikimit periodik nëpërmjet inspektimeve në shoqëritë e sigurimit dhe Byronë Shqiptare të Sigurimit për saktësinë e të dhënave të raportuara

dhe monitorimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, për dëmet objekt i Fondit të Kompensimit;

- Monitorimit të veprimtarisë promocionale dhe transparencës së subjekteve të mbikëqyrura, në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit, si dhe angazhimit nga ana e tij për hartimin e disa dokumenteve shumë të rëndësishme në këtë drejtim, siç janë: "Strategjia për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje" dhe "Karta e të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje";

- Shqyrtimit dhe trajtimit nëpërmjet regjistrit *online* të një numri total prej 183 ankesash të konsumatorëve dhe investitorëve, nga të cilat vetëm 2 ankesa lidhen me fondet vullnetare të pensionit dhe fondet e investimeve, ndërsa 181 ankesat e tjera i përkasin tregut të sigurimeve dhe më së shumti sigurimit të detyrueshëm motorik dhe sigurimit nga tërmeti;

- Digjitalizimit dhe modernizimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të dy sistemeve të raportimit të shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje, përshtatjes së plotë të Regjistrit Elektronik *Online* të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik me sistemet e reja të institucioneve, me të cilat bashkëvepron sistemi i AMF-së dhe përfundimit të analizës teknike dhe ndjekjes në vijim të procesit për ofrimin e disa shërbimeve të tregjeve të mbikëqyrura nëpërmjet platformës *e-Albania*;

- Bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizata ndërkombëtare, si: IOSCO dhe IOPS nëpërmjet përshtatjes së rekomandimeve dhe planeve të veprimit të propozuara nga këto organizata për përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga pandemia.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

- Të plotësojë, brenda vitit 2021, të gjithë kuadrin nënligjor nën zbatim të ligjeve të miratuara nga Kuvendi për tregjet e kapitalit, fondet e investimit dhe sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, të cilat do të shërbejnë jo vetëm për modernizimin e tregjeve me praktikat e vendeve evropiane, por edhe për krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e tyre;

- Të nxisë pjesëmarrjen në skemat profesionale të pensionit dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të fondeve të pensioneve vullnetare nëpërmjet përafrimit të ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar" me direktivat e BE-së në këtë fushë, me qëllim krijimin e formave të ndryshme të fondeve të pensionit, që do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në ndërgjegjësimin e kompanive dhe industrive vendase si një politikë për motivimin e punonjësve të tyre;

- Të përmirësojë praktikat mbikëqyrëse, si dhe të avancojë më tej drejt mbikëqyrjes së plotë me bazë riskun, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dhe modernizimit të sistemeve të raportimit në funksion të rritjes së eficiencës në proceset mbikëqyrëse;

- Të fokusohet në monitorimin e vazhdueshëm të treguesve financiarë të subjekteve të mbikëqyrura, si dhe të nxisë zhvillimet e reja në drejtim të krijimit të produkteve dhe shërbimeve inovative nëpërmjet digjitalizimit;

- Të përfundojë, brenda vitit 2021, procesin për ofrimin e shërbimeve të verifikimit të policës së sigurimit motorik, vërtetimit të historikut të mjetit dhe vërtetimit të historikut të dëmit nëpërmjet platformës *e-Albania*;

- Në funksion të transparencës, të vazhdojë publikimin e vendimeve të Bordit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, të paraqesë në Kuvend së bashku me raportin vjetor informacion të hollësishëm për vendimet e ankimuara të Bordit dhe rezultatin e inspektimeve të subjekteve të mbikëqyrura;

- Të ketë në fokus zhvillimin profesional dhe motivimin e punonjësve për arritjen e objektivave të institucionit, duke i përfshirë jo vetëm në trajnime të profilizuara sipas dinamikës së tregjeve nën mbikëqyrje, por edhe në trajnime për rritjen e kapaciteteve për sa i takon forcimit të luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

- Të monitorojë në vijimësi ndërmjetësit që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje, si dhe të angazhohet në nisma dhe aktivitete edukuese e promovuese, me qëllim mbrojtjen e personave të siguruar dhe investitorëve.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 27.5.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE, PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur misionin e INSTAT-it për prodhimin e statistikave asnjanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit;

Duke marrë në konsideratë se INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend dhe përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;

Duke vlerësuar se statistikat zyrtare shpërndahen, duke respektuar parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke siguruar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave zyrtare, brenda dhe jashtë vendit, për të plotësuar nevojat e tyre me informacion cilësor e të përditësuar dhe për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera në rajon dhe Evropë,

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Statistikave gjatë vitit 2020, në drejtim të:

- Analizimit të rezultateve të Pilotit të Censit, rishikimit të strategjisë, planit të aktiviteteve dhe matjes së impaktit që solli ky proces në koston për kryerjen e Censit;

- Miratimit të planit të vazhdimësisë për 72 aktivitete statistikore, shoqëruar edhe me përditësimin e regjistrit të riskut, në kuadër të masave për menaxhimin e situatës së krijuar nga COVID-19;

- Fuqizimit të kapaciteteve IT nëpërmjet ndërtimit të sistemit të integruar të të dhënave (SIMONA), i cili mundëson aksesin e të dhënave mikro në interes të proceseve kërkimore-shkencore, si dhe të stafit të INSTAT-it;

- Zgjerimit të gamës së produkteve në kuadër të edukimit statistikor, duke publikuar për herë të parë gjashtë tema statistikore për kategorinë nxënës dhe studentë, duke publikuar për herë të parë indeksin e barazisë gjinore për Shqipërinë dhe forcuar bashkëpunimin me botën akademike;

- Krijimit të Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare për të siguruar cilësinë në proceset e planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore;

- Kontributit në drejtim të standardizimit të metodologjive, garantimit të konfidencialitetit, modernizimit të infrastrukturës për përpunim statistikor dhe vizualitetit të produkteve statistikore.

Kuvendi rekomandon që Instituti i Statistikave, për vitin 2021, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të publikojë raportet e rekomandimeve të lëna nga Këshilli i Statistikave dhe aktet e miratuara nga Bordi Drejtues, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, si dhe të publikohet pjesëmarrja e anëtarëve dhe mënyra e votimit;

- Të marrë masa për funksionimin e të gjithë mekanizmave organizativë e mbështetës, me qëllim shmangien e shtyrjes së dytë të zhvillimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave, si dhe hartimin e një strategjie efektive komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës për rëndësinë e Censit;

- Të raportojë ecurinë e planit të punës për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave në raportet 4-mujore, për ecurinë e Programit të Statistikave Zyrtare që i paraqiten Këshillit të Statistikave dhe këto raporte të publikohen në faqen zyrtare të INSTAT-it;

- Të intensifikojë rolin e Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare veçanërisht në proceset e përgatitjes së projekt-Programit të Statistikave Zyrtare, si dhe të publikohet veprimtaria e tij në faqen zyrtare të INSTAT-it;

- Të paraqesë brenda vitit projekt-Programin e ri të Statistikave Zyrtare 2022–2026, sipas strukturës së parashikuar nga legjislacioni për statistikat zyrtare, por edhe për të siguruar një Sistem Kombëtar Statistikor me pjesëmarrje më të gjerë institucionesh publike;

- Të finalizojë hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Censin e Bujqësisë duke planifikuar dhe detajuar elementet më të rëndësishme të projektit, të përgatisë kuadrin rregullator dhe të vlerësojë burimet dhe aktorët që do të përfshihen;

- Të marrë masa konkrete në drejtim të automatizimit të proceseve të punës, të zhvillojë dhe testojë sistemet e Teknologjisë së Informacionit për pyetësorin elektronik e sistemin

e monitorimit të procesit në terren dhe të sigurohet për trajnimin e përdoruesve të këtyre sistemeve;

- Të përafrojë në vazhdimësi standardet sipas Parimeve të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, me synim përmirësimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit, publikimit të të dhënave dhe rritjen e besueshmërisë në statistikat zyrtare;

- Të mundësojë prezencën në media të përfaqësuesve të INSTAT-it, me qëllim informimin e publikut të gjerë për metodat e përllogaritjes së treguesve statistikorë në funksion të rritjes së kuptueshmërisë dhe besueshmërisë në statistikat zyrtare të prodhuara.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 27.5.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke vlerësuar rolin e Bankës së Shqipërisë në mbikëqyrjen e sistemit financiar të vendit dhe nxitjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë;

Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Bankës së Shqipërisë në raport me ligjin, si dhe detyrimin për zbatimin dhe raportimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë;

Duke vlerësuar angazhimin e Bankës së Shqipërisë për zbatimin e objektivave dhe detyrimeve të saj ligjore;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2020 për përmbushjen e funksioneve të saj dhe të objektivave strategjikë afatmesëm në këto drejtime:

- Ndjekjes në vazhdimësi të një politike monetare lehtësuese nëpërmjet normës së ulët të interesit dhe furnizimit të pakufizuar me likuiditet të sistemit financiar duke përdorur të njëjtin kuadër instrumentesh si në vitin 2019.

- Intensifikimit të punës për përmirësimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës duke e përafruar me aktet e BE-së, me parimet e Komitetit të Bazelit dhe me praktikat më të mira të mbikëqyrjes bankare.

- Forcimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes të bazuar në rrezik duke miratuar një numër ndryshimesh në rregulloret për parimet bazë të drejtimit të bankave, për sistemin e kontrollit të brendshëm, dhe në Sistemin e Vlerësimit të Rreziqeve – përkatësisht për rrezikun organizativ dhe rrezikun e kredisë.

- Përmirësimit më tej të politikave të saj në drejtim të portofolit të kredisë për të ndikuar në reduktimin e kredive me probleme dhe për të mos lejuar krijimin e kredive të reja të kësaj natyre, por situata e pandemisë pati ndikim edhe në aftësinë paguese të kredimarrësve, si dhe në pozicionin financiar të bankave dhe institucioneve financiare jobanka.

- Shtimit të inspektimeve në vend për të gjitha subjektet e mbikëqyrura për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL, veçanërisht subjektet financiare jobanka (SFJB) dhe zyrat e këmbimit valutor (ZKV), duke realizuar një numër total prej 89 inspektimesh për vitin 2020.

- Vijimit të përpjekjeve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Pagesat në Vlerë të Vogël dhe miratimit të disa masa rregullative për reduktimin e kostove të pagesave nëpërmjet internetit, me qëllim promovimin dhe nxitjen e përdorimit të tyre nga publiku i gjerë. Mori masat për hartimin e aktit për transpozimin e Direktivës së BE-së "Për llogarinë e pagesave", synimi i së cilës është nxitja e transparencës, e konkurrueshmërisë dhe e përfshirjes financiare të popullsisë. Këto ndryshime janë pjesë e masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, ku tashmë 50% e tyre janë realizuar.

- Pasurimit dhe zhvillimit më tej të kuadrit metodologjik dhe rregullativ në fushën e stabilitetit financiar dhe politikës makroprudenciale në përputhje me rekomandimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik, duke shtuar analizat për monitorimin e kujdesshëm të sistemit financiar në kontekstin e pandemisë.

- Monitorimit të procesit të administrimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe rritjes së nivelit të automatizimit të tij, si dhe miratimit të disa rregulloreve në përputhje me dispozitat ligjore për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

- Vijimit të punës për kompletimin e serisë së re me kartëmonedhat e prerjes 1.000 lekë dhe 10.000

lekë, të cilat do të hidhen në qarkullim gjatë vitit 2021.

- Administrimit të rezervës valutore në përputhje me politikën e administrimit, ku objektiv parësor është parimi i likuiditetit dhe ai i sigurisë. Gjatë vitit 2020 rezerva valutore është rritur me rreth 586 milionë euro, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 3.9 miliardë euro, nivel ky në përputhje me kriteret për mjaftueshmërinë e rezervës.

- Harmonizimit më tej të statistikave me *acquis communautaire*, ku veçohen statistikat e detajuara për kredimarrësin dhe letrat me vlerë.

- Intensifikimit të punës kërkimore në mbështetje të vendimmarrjes dhe rritjes së transparencës, me fokus analizat dhe eksplorimin e fenomeneve ekonomike e financiare në kushtet e diktuara nga pandemia COVID-19.

Kuvendi kërkon që Banka e Shqipërisë për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

- Ruajtjen e një qëndrimi të përshtatshëm të politikës monetare, të tillë që të mundësojë përmbushjen e objektivit të inflacionit brenda një kohe të mjaftueshme dhe të ndihmojë rikuperimin e aktivitetit ekonomik në periudhën e post-pandemisë. Përmirësimin e komunikimit me publikun, si dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët brenda dhe jashtë vendit, në interes të rritjes së sinergjisë së politikave të brendshme ekonomike dhe të mbështetjes së procesit të integrimit evropian.

- Ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit financiar dhe monitorimin e kujdesshëm të efekteve si pasojë e pandemisë së shkaktuar prej COVID-19.

- Zhvillimin e kuadrit rregullativ për instrumentet makroprudenciale që adresojnë rreziqet sektoriale.

- Zhvillimin e metodologjive dhe procedurave për ndërtimin e kuadrit rregullator që mundëson vlerësimin e rrezikut sistemik, që buron prej ndërveprimit/ ndërlidhjes me segmentet jobankare të sistemit financiar.

- Fuqizimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka nëpërmjet hartimit dhe përditësimit të rregullt të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, përcaktimit të nivelit të synuar të kërkesave minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuara.

- Përfundimin brenda vitit 2021 të hartimit të kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, më konkretisht të akteve që rregullojnë njohjen kontraktuale të rikapitalizimit nga brenda, kushtet dhe kriteret për përcaktimin e normave të konvertimit të borxhit në kapital.

- Vijimin e punës për zgjerimin e kapaciteteve institucionale dhe plotësimin e kuadrit rregullativ të nevojshëm për kryerjen e një mbikëqyrjeje efektive të operatorëve për infrastrukturat e klerimit e të shlyerjes së titujve.

- Konsolidimin e një mjedisi rregullator lehtësues për pagesat me vlerë të vogël, nxjerrjen brenda vitit 2021 të akteve nënligjore në zbatim të ligjit "Për shërbimet e pagesave", si dhe përgatitjen e akteve ligjore që sigurojnë përputhshmërinë me Direktivën e Bashkimit Evropian për Llogaritë e Pagesave.

- Nxitjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave nëpërmjet zhvillimeve infrastrukturore për të garantuar funksionimin e sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët të tyre, si dhe të përfundojë brenda vitit 2021 implementimin e projektit të shlyerjes së transfertave në euro të klientëve të bankave tregtare në territorin shqiptar e të finalizojë hartimin e skemës së debitimit direkt ndërbankar.

- Përmirësimin e cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim nëpërmjet rritjes së efektivitetit he kapacitetit në veprimtarinë përpunuese të kontrollit të përhershëm dhe nxitjes së sistemit bankar në përdorimin e sistemeve të certifikuara dhe të autorizuara nga Banka e Shqipërisë për pranimin dhe përpunimin e kartëmonedhave.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 27.5.2021.

VENDIM
Nr. 214, datë 26.5.2021

PËR MIRATIMIN E FORMËS STANDARDE TË AKTEVE TË VLERËSIMIT TË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja "a" të Kushtetutës, nenet 2, 70, pika 3, 74–78, 84–95, 97 dhe 171 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 193, datë 12.5.2021, "Për miratimin e 'Metodologjia e pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë"' dhe nr. 194, datë 12.5.2021, "Për miratimin e 'Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë"', me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e formës standarde të akteve të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, sipas lidhjeve 1, 2 dhe 3 pjesë e përbërëse e këtij vendimi.
2. Format standarde të akteve të vlerësimit hartohen në format shkresor dhe/ose elektronik, të cilët kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Naureda Llagami

Lidhja I

FORMULAR I VETËVLERËSIMIT TË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË

Për periudhën e vlerësimit 20__–20 ___

TË DHËNAT E NDIHMËSMAGJISTRATIT
Emri:
Mbiemri:
Datëlindja:
Vendbanimi:
Adresa e *email*-it zyrtar:
Adresa e *email*-it privat:
Numër telefoni:
Gjykata:
Funksioni:

Formulari i vetëvlerësimit (më poshtë "formulari") dhe hapat për plotësimin e tij

1. Ky formular vetëvlerësimi plotësohet nga ndihmësmagjistrati, në zbatim të nenit 86 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (ligji për statusin).

2. Ky formular është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 77, shkronjat "ç" dhe "d" të ligjit për statusin.

3. Formularit i bashkëngjiten dy dokumente ligjore të përzgjedhura prej ndihmësmagjistratit për secilin vit vlerësimi, si dhe dokumente që tregojnë angazhimin në veprimtaritë profesionale ndërinstitucionale gjatë periudhës së vlerësimit, trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës (përmbajtja, kohëzgjatja, të dhëna mbi institucionin organizues) dhe çdo dokument tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit. Dokumentet për trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës duhet të evidentojnë përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin.

4. Ndihmësmagjistrati plotëson formularin në rubrikat përkatëse të caktuara për të dhe ia dorëzon kryetarit të Gjykatës së Lartë, brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional.

5. Formulari plotësohet në mënyrë elektronike dhe nënshkruhet nga ndihmësmagjistrati.

6. Ndihmësmagjistrati vetëvlerësohet sipas katër grup-kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi.

7. Ndihmësmagjistrati bën vetëvlerësimin e aftësive organizative, duke përzgjedhur shkallën e aftësisë për çdo tregues vlerësimi mbi bazën e një analize të pavarur të të dhënave të tij statistikore, referuar tabelave statistikore që i janë vënë në dispozicion para fillimit të procesit të vlerësimit.

8. Ndihmësmagjistrati ka të drejtë të japë shpjegime dhe të argumentojë vetëvlerësimin e tij, duke parashtruar të dhënat, kushtet e punës dhe arsyet që sipas tij/saj justifikojnë një shkallë më të lartë aftësie se ajo që rezulton nga të dhënat statistikore.

VETËVLERËSIMI KUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të ndihmësmagjistratit vlerësohet aftësia e tij në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

1.A Njohuritë ligjore

1.A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përcaktuar dhe renditur rrethanat e çështjes, ecurinë procedurale të saj, shkaqet e rekursit/investimit të Gjykatës së Lartë, identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, ligjin e zbatueshëm, konfliktin e normave sipas rastit. Gjithashtu, vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për t'i parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator/kolegji.*** ***Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)*				

1.A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore materiale ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e analizës ose opinionit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të interpretuar ligjin e identifikuar, analiza për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi, të cilat vlerësohen në kontekst të çështjes. Në këtë rast vlerësohet aftësia për t'u bazuar te parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, për të kërkuar, njohur dhe analizuar jurisprudencën vendëse dhe ndërkombëtare/GJEDNJ, duke u përqendruar te një çështje të caktuar, sa dhe si ndihmësmagjistrati identifikon praktikën gjyqësore vendëse dhe atë ndërkombëtare, në mbështetje të një vendimi ose interpretimi të caktuar, si përdor dhe krahason burime jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendës dhe nga sisteme të tjera.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)*

1.B Arsyetimi ligjor

1.B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë i qartë, konciz, elokuent dhe lehtësisht i kuptueshëm në dokumentet ligjore të hartuara prej tij, si dhe në prezantimet verbale para kolegjit, kur i kërkohet, aftësia për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurës së zbatueshme, arsyetimit të gjykatave më të ulëta dhe çështjeve të tjera ligjore. Vlerësohet aftësia për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe në mënyrë të përmbledhur, zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe i atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shume e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)*

1.B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet nëse dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati dhe ato të përzgjedhura me short përmbajnë një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirorganizuar, e cila respektohet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)*

1.B-c Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik				
Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar. Në veçanti, në dokumentet ligjore të dorëzuara prej tij dhe ato të përzgjedhura me short, vlerësohet nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha çështjeve ligjore që ngrihen për diskutim, si dhe nëse nga ana e ndihmësmagjistratit evidentohet nevoja për të njësuar apo ndryshuar praktikën gjyqësore. ***Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)*				

2. Vlerësimi i aftësive organizative të ndihmësmagjistratit

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë, menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e çështjeve që ai përgatit në funksion të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore nga gjykata në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në kolegje. Ky komponent vlerësohet sipas tri aspekteve: sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A-a Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore		
Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë, sipas standardit minimal të caktuar, për çdo kategori çështjesh, e cila matet ndërmjet krahasimit të numrit total të çështjeve të përgatitura për shqyrtim (të përfunduara + të papërfunduara), me standardin sasior të përcaktuar. ***Ndihmësmagjistrati bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.***		
Nën standard ☐	Në standard ☐	Mbi standard ☐
Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar "Metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 193, datë 12.5.2021, deri në pikëzim maksimal.)*		

2.A-b Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore				
Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për përfundimin e dokumenteve ligjore, duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve të përgatitura për shqyrtim (të përfunduara + të papërfunduara) pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve të caktuara për relatim brenda një viti kalendarik. ***Ndihmësmagjistrati bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.***				
Nën 81 % ☐	Mbi 81–87 % ☐	Mbi 87–93 % ☐	Mbi 93–99 %	+99% ☐

Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë, referuar "Metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 193, datë 12.5.2021, deri në pikëzimin maksimal, nëse ndihmësmagjistratit ka përfunduar brenda të njëjtit viti kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal sasior të përcaktuar nga mbledhja e gjyqtarëve dhe/ose kryetari.)*

B. Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara

2.B-a Respektimi i standardeve minimale kohore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të respektuar afatet orientuese të miratuara për çdo kategori çështjesh, referuar raportit të çështjeve për të cilat dokumentet ligjore janë përgatitur tej standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të përgatitura (të përfunduara + të papërfunduara).

Ndihmësmagjistrati bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

1–10 % ☐	11–20 % ☐	21–30 % ☐	31–40 % ☐	Mbi 40 % ☐

Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar "Metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 193, datë 12.5.2021 deri në pikëzim maksimal.)*

2.B-b Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje të përgatitur për relatim

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përpunuar dokumentet ligjore për çdo çështje në afat, sipas kategorisë përkatëse, në raport me standardet minimale kohore të miratuara, për çdo kategori.
Ndihmësmagjistrati bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij. Ai përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme pas krahasimit me standardet e miratuara.

Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve ☐	Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve ☐	Më e gjatë se standardi për gjysmën kategorive të çështjeve☐	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve ☐	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve☐

Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar "Metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë", miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 193, datë 12.5.2021 deri në pikëzim maksimal.)*

C. Metodologjia e punës (aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës)

2.C-a Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit në drejtim të dhënies së ndihmës dhe kontributit aktiv për kryerjen me eficiencë të veprimeve, të tilla si: respektimin e rendit kronologjik të çështjeve për t'u përgatitur në përputhje me afatet ligjore; respektimin e afateve të përcaktuara nga gjyqtari relator/kolegji në kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës; planifikimin dhe zhvillimin e seancave me apo pa pjesëmarrjen e palëve (njoftimin, shpalljen etj.); dokumentimin e vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale; ndjekjen me rigorozitet të seancave apo diskutimeve për çështjen; ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve nëse kërkohet nga gjyqtari relator.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

2.C-b Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relatim, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të evidentuar shpejt dhe pa humbur kohë çështje që kërkojnë vëmendje të posaçme, si p.sh.: kërkesat për përshpejtim, pezullim, rastet kur kërkohet apo është e nevojshme përjashtimi i gjyqtarit relator apo raste të tjera të ngjashme, me qëllim evitimin e vonesave në shqyrtimin e çështjeve.

Si e vlerëson ndihmëmagjistrati shkallën e aftësisë se tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime:

2.C-c Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për ruajtjen e renditjes së akteve të dosjes dhe të materialeve të tjera dokumentare, në mënyrë të tillë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, si dhe aftësia e tij për të garantuar rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumenteve pjesë e dosjes gjyqësore, që krijohet në Gjykatën e Lartë, nga momenti i marrjes së saj deri në dorëzimin në sekretari pas përfundimit të çështjes.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime:

3. Vlerësimi i etikës dhe i angazhimit ndaj vlerave profesionale

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat, për shkak të statusit të tij ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore, në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë

3.A-a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbajtje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetën më shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e tij të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion?

E dobët☐	Nën mesatare☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime:

3.B Integriteti

3.B-a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të respektuar, miratuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti; aftësia për t'iu përgjigjur pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë, duke vepruar me vetëdije se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja e tij në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe të besimit të publikut. Shmangia e shfaqjes së pahijshme është themelore për integritetin. Gjatë punës së tyre si ndihmësmagjistratë ata duhet të përpiqen të shmangin të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme gjatë hartimit të dokumenteve ligjore për çështjet në gjykim. Ndihmësmagjistratët, megjithëse nuk kryejnë funksione vendimmarrëse por ndihmëse, nuk duhet të mbajnë qëndrime favorizuese ose disfavorizuese, në lidhje me çështjet për të cilat japin kontributin e tyre ndihmës për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë.*** ***Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij?*** *(Prezumohet se ndihmësmagjistrati ka shkallë shumë të lartë integriteti.)*

E dobët☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime:	

3.C Paanësia

3.C-a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese ***Me këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykime.*** ***Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese?***

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shume e lartë☐
Shpjegime:				

3.C-b Numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shfaqur paanësi në funksion, referuar raportit të numrit të çështjeve të caktuara ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit dhe numrit të kërkesave të bëra prej tij për heqje dorë, të refuzuara nga kryetari.*** ***Si e vlerëson ndihmësmagjistrati numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari?***

Tejet i lartë ☐	I pakonsiderueshëm ☐
Shpjegime:	

4. Vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimit profesional

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistratit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e gjykatës, gatishmëria e tij për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A-a Komunikimi i qartë dhe transparent

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, publikun (nëse është rasti), subjektet e tjera dhe të tretët.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

4.A-b Respektimi i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave personale

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të treguar kujdes për ruajtjen e konfidencialiteti dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me informacionit dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit.

Si e vlerëson ndihmëmagjistrati aftësinë e tij, në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe të dhënave personale?

I dobët ☐	Mesatar ☐	I lartë ☐

Shpjegime:

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B-a Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe disponibiliteti i ndihmësmagjistratit për të bashkëpunuar me kolegët, pa cenuar pavarësinë e tij, aftësia për të kontribuar në ngritjen e problemeve, diskutimin dhe propozimet mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit apo ndryshimit të vendimeve njësuese, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë gjyqësore. Vlerësohet gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të ndarë me kolegët përvojën e përftuar në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij, në lidhje me shkallën e komunikimit dhe të bashkëpunimin me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta?

E dobët ☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime:

4.B-b Gatishmëria dhe kontributi për të kryer edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të Gjykatës

Në këtë tregues vlerësohet gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të dhënë kontributin e tij edhe në çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, si p.sh. propozime për ndryshime ligjore, përmirësimin e akteve të brendshme rregulluese të gjykatës, organizimin me efecient të administratës gjyqësore etj.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen?

Shpjegime: *(Ndihmësmagjistrati duhet listojë të dhënat mbi kontributin e dhënë dhe produktet konkrete të përgatitura në kuadër të kësaj veprimtarie.)*

4.B-c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë bashkëpunues, për të reaguar me efikasitet në rast të shfaqjes së problemeve apo vështirësive në punë, duke ruajtur qetësinë, etikën dhe synuar zgjidhjen e menjëhershme dhe me efektivitet të konflikteve. Vlerësohet veçanërisht marrëdhënia korrekte me gjyqtarët, kancelarin dhe administratën gjyqësore.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për të bashkëpunuar dhe reaguar me efikasitet në rast nevoje?

E dobët ☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime:

4.C Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C-a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Në këtë tregues vlerësohet angazhimi i ndihmësmagjistratit në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe në aktivitete të tjera trajnuese jashtë këtij programi, me qëllim ngritjen e tij profesionale.

A e ka përmbushur ndihmësmagjistrati detyrimin ligjor mbi pjesëmarrjen në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, gjatë periudhës së vlerësimit?

Po ☐	Jo ☐

Shpjegime: *(Këtu ndihmësmagjistrati duhet të përcaktojë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të zhvilluara jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke specifikuar përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.)*

4.C-b Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve.

Në këtë tregues vlerësohet gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të kontribuar si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera.

Shpjegime: *(Ndihmësmagjistrati duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtaritë trajnuese në të cilat është angazhuar.)*

4.C-c Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e ndihmësmagjistratit për t'u angazhuar në veprimtari për të përmirësuar sistemin e drejtësisë, me ose pa pagesë, të tilla si: prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrje në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e eficiencës; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm, me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.***
Shpjegime: (*Ndihmësmagjistrati duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, si dhe kontributin e tij në këto veprimtari.*)
4.C-ç Publikime ligjore akademike ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të publikuar shkrime, artikuj ligjorë me natyrë akademike ose praktike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës apo njohjen e praktikantëve të së drejtës me zhvillimet më të fundit të jurisprudencës vendëse dhe të huaj.***
Shpjegime: *(Ndihmëmagjistrati duhet të listojë këtu informacione mbi botimet e tij si p.sh. të dhënat për sasinë, tipologjinë dhe impaktin e publikimeve ligjore akademike. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.*)

Në referim të nenit 86, pika 1, shkronjat "c", "ç", "d", "dh" të "Ligjit për statusin", ndihmësmagjistrati jep mendim për sa më poshtë:

a) Masat e ndërmarra për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në vlerësimin e mëparshëm dhe shkalla e përmbushjes së tyre.

Shpjegime:

b) Objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm.

Shpjegime:

c) Nevojat për trajnim dhe rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional, duke propozuar zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

Shpjegime:

Në referim të nenit 86, pika 2, të "Ligjit për statusin" ndihmësmagjistrati i bashkëlidh formularit të vetëvlerësimit dy dokumente ligjore të përzgjedhura prej tij, për çdo vit të periudhës së vlerësimit.

a) Dokumentet ligjore të përzgjedhura nga ndihmësmagjistrati

Dokumentet ligjore të përzgjedhura listohen në këtë rubrikë dhe i bashkëlidhen formularit të vetëvlerësimit.

Për t'u plotësuar nga ndihmësmagjistrati:

Plotësuar nga	**Emër:**	**Mbiemër:**	**Nënshkrimi:**
Dorëzuar në datën			
Marrë në dorëzim nga kryetari	**Emër:**	**Mbiemër:**	**Nënshkrimi:**

Lidhja II

FORMULAR I MENDIMIT TË KOLEGJIT
PËR VLERËSIMIN E NDIHMËSMAGJISTRATIT
NË GJYKATËN E LARTË
Për periudhën e vlerësimit 20__–20 ___

TË DHËNAT E NDIHMËSMAGJISTRATIT
Emri:
Mbiemri:
Datëlindja:
Vendbanimi:
Adresa e *email*-it zyrtar:
Adresa e *email*-it privat:
Numër telefoni:
Gjykata:
Funksioni:

Formulari i mendimit të kolegjit (më poshtë "formulari") dhe hapat për plotësimin e tij:

1. Ky formular përmban mendimin dhe vlerësimin që kolegji i bën veprimtarisë së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.

2. Ky formular është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 77, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (ligji për statusin), si dhe vendimit të KLGJ nr. 194, datë 12.5.2021, "Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë".

3. Formulari plotësohet nga kolegji pranë të cilit ndihmësmagjistrati ka ushtruar funksionin. Në rast se ndihmësmagjistrati, gjatë periudhës së vlerësimit, ka ushtruar funksionin në më shumë se një kolegj të Gjykatës së Lartë, formulari plotësohet nga secili kolegj më vete.

4. Kolegji, brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional, plotëson formularin, në rubrikat përkatëse dhe ia dërgon kryetarit të Gjykatës së Lartë.

5. Formulari plotësohet në mënyrë elektronike dhe nënshkruhet nga anëtarët e kolegjit.

Vlerësimi i kolegjit bazohet në standardet e mëposhtme:

6. Në mendimin e kolegjit përshkruhet dhe vlerësohet veprimtaria e ndihmësmagjistratit sipas katër grup-kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, konkretisht për:

- aftësitë profesionale;
- aftësitë organizative;
- etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

7. Për kriterin e "Aftësive profesionale" kolegji jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Njohuritë ligjore, duke dhënë mendim për:

a) aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave;

b) aftësinë për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore dhe materiale ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e dokumentit ligjor.

ii. Arsyetimi ligjor, duke dhënë mendim, për:

a) qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e dokumentit ligjor;

b) strukturën e qëndrueshme dhe të mirorganizuar të dokumentit ligjor;

c) cilësinë e analizës dhe argumentimin logjik.

8. Për kriterin e "aftësive organizative", kolegji vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë (treguesi sasior), nëpërmjet:

a) treguesit sasiorë në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore;

b) rendimentit të përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore;

ii. Aftësinë për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara (treguesi i shpejtësisë), në drejtim të:

a) respektimit të standardit minimal kohor;

iii. Metodologjisë së punës (aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës), në drejtim të:

a) aftësisë për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor;

b) aftësisë për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relatim, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi për shkak të kërkesave procedurale;

c) rregullshmërisë, saktësisë e plotësisë së dosjes gjyqësore.

9. Për kriterin e "etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale", kolegji jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Etikën në punë, e vlerësuar nëpërmjet angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion;

ii. Integritetin e ndihmësmagjistratit, i vlerësuar nëpërmjet shmangies së shfaqjes së pahijshme dhe transmetimit të vlerave personale dhe profesionale si nderi dhe dinjiteti;

iii. Paanësinë në funksion, e vlerësuar nëpërmjet përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese.

10. Për kriterin "aftësitë personale dhe angazhimi profesional", kolegji jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Aftësitë e komunikimit, nëpërmjet:

a) komunikimit të qartë dhe transparent;

b) respektimit të konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

11. Vlerësimi për etikën, integritetin dhe paanësinë jepet bazuar mbi prezumimin se ndihmësmagjistrati i ka këto cilësi. Kolegji parashtron dhe jep mendim për problematika të shfaqura nga ndihmësmagjistrati, të tilla që duhet të merren parasysh në vlerësim.

12. Vlerësimi i kolegjit bazohet në të dhëna objektivisht të konstatuara gjatë gjithë veprimtarisë së ndihmësmagjistratit, pavarësisht të dhënave që përmbajnë burimet e tjera të vlerësimit.

13. Mendimi i kolegjit jepet duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në nenin 78 të ligjit për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi. Kolegji jep shpjegime dhe argumenton mendimin e tij.

14. Nëse kryetari i Gjykatës është njëkohësisht edhe anëtar i kolegjit, ai jep mendimin e tij në këtë formular vetëm për kriterin e aftësive profesionale. Mendimi i kryetarit për tri kriteret e tjera jepet në formularin e mendimit të kryetarit.

VLERËSIMI KUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit.

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të ndihmësmagjistratit vlerësohet aftësia e tij në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

1.A Njohuritë ligjore

1.A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përcaktuar dhe renditur rrethanat e çështjes, ecurinë procedurale të saj, shkaqet e rekursit/investimit të Gjykatës së Lartë, identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, ligjin e zbatueshëm, konfliktin e normave sipas rastit. Gjithashtu, vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për t'i parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator/kolegji.*** ***Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*				
1.A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore materiale ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e analizës ose opinionit ligjor ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të interpretuar ligjin e identifikuar, analiza për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi, të cilat vlerësohen në kontekst të çështjes. Në këtë rast vlerësohet aftësia për t'u bazuar te parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, për të kërkuar, njohur dhe analizuar jurisprudencën vendëse dhe ndërkombëtare/GJEDNJ, duke u përqendruar te një çështje e caktuar, sa dhe si ndihmësmagjistrati identifikon praktikën gjyqësore vendëse dhe atë ndërkombëtare, në mbështetje të një interpretimi të caktuar, si përdor dhe krahason burime jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendës dhe nga sisteme të tjera.*** ***Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*				

1.B Arsyetimi ligjor

1.B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë i qartë, konciz, elokuent dhe lehtësisht i kuptueshëm në dokumentet ligjore të hartuara prej tij, si dhe në prezantimet verbale para kolegjit, kur i kërkohet, aftësia për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurës së zbatueshme, arsyetimit të gjykatave më të ulëta dhe çështjeve të tjera ligjore. Vlerësohet aftësia për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe në mënyrë të përmbledhur, zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe i atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shume e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

1.B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet nëse ndihmësmagjistrati ndjek një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirorganizuar në përpilimin e dokumentit ligjor, e cila respektohet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura.

Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shume e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

1.B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situate të caktuar. Vlerësohet nëse përmbajtja e dokumenteve ligjore është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha çështjeve ligjore që ngrihen për diskutim. Vlerësohet në veçanti aftësia e ndihmësmagjistratit për evidentimin dhe parashtrimin e nevojës për të njësuar apo ndryshuar praktikën e gjykatës.

Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

2. Vlerësimi i aftësive organizative të ndihmësmagjistratit

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë, menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e çështjeve që ai përgatit në funksion të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore nga gjykata në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në kolegje. Ky komponent vlerësohet sipas tri aspekteve: sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A-a Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë, referuar standardit sasior të përcaktuar.

Kolegji jep mendim për shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit për këtë tregues.

Nën standard ☐	Në standard ☐	Mbi standard ☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

2.A-b Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përfunduar hartimin e dokumenteve ligjore për të gjitha çështjet e caktuara për relatim brenda një viti kalendarik.

Kolegji jep mendim për shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit për këtë tregues.

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesatare ☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

B. Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara

2.B-a Respektimi i standardeve minimale kohore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të respektuar afatet orientuese të miratuara për çdo kategori çështjesh.

Kolegji jep mendim për shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit për këtë tregues.

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

C. Metodologjia e punës (aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës)

2.C-a Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit në drejtim të dhënies së ndihmës dhe kontributit aktiv për kryerjen me eficiencë të veprimeve, të tilla si: respektimin e rendit kronologjik të çështjeve për t'u përgatitur në përputhje me afatet ligjore; respektimin e afateve të përcaktuara nga gjyqtari relator/kolegji në kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës; planifikimin dhe zhvillimin e seancave me apo pa pjesëmarrjen e palëve (njoftimin, shpalljen etj.); dokumentimin e vendimeve dhe të veprimeve të tjera procedurale; ndjekjen me rigorozitet të seancave apo diskutimeve për çështjen; ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve, nëse kërkohet nga gjyqtari relator.

Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*
2.C-b Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relatim, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të evidentuar shpejt dhe pa humbur kohë çështje që kërkojnë vëmendje të posaçme si p.sh.: kërkesat për përshpejtim, pezullim, rastet kur kërkohet apo është e nevojshme përjashtimi i gjyqtarit relator apo raste të tjera të ngjashme, me qëllim evitimin e vonesave në shqyrtimin e çështjeve.*** ***Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?***

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*
2.C-c Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për ruajtjen e renditjes së akteve të dosjes dhe materialeve të tjera dokumentare, në mënyrë të tillë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, si dhe aftësia e tij për të garantuar rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumenteve pjesë e dosjes gjyqësore që krijohet në Gjykatën e Lartë, nga momenti i marrjes së saj deri në dorëzimin në sekretari pas përfundimit të çështjes.*** ***Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?***

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale.

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat, për shkak të statusit të tij ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore, në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë

3.A-a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbajtje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetën më shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin.*** ***Si e vlerëson kolegji shkallën angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion të ndihmësmagjistratit?***

E dobët☐	Nën mesatare☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

3.B Integriteti

3.B-a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të respektuar, miratuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti; aftësia për t'iu përgjigjur pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë, duke vepruar me vetëdije se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja e tij në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Ndihmësmagjistrati duhet të jetë i vetëdijshëm se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Shmangia e shfaqjes së pahijshme është themelore për integritetin. Gjatë punës së tyre si ndihmësmagjistratë ata duhet të përpiqen të shmangin të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme për gjykimin e tyre gjatë hartimit të dokumenteve ligjore për çështjet në gjykim. Ndihmësmagjistratët, megjithëse nuk kryejnë funksione vendimmarrëse por ndihmëse, nuk duhet të mbajnë qëndrime favorizuese ose disfavorizuese, në lidhje me çështjet për të cilat japin kontributin e tyre ndihmës për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë.*** ***Si e vlerëson kolegji aftësinë e ndihmësmagjistratit për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij?*** *(Prezumohet se ndihmësmagjistrati ka shkallë shumë të lartë integriteti.)*

E dobët☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*	

3.C Paanësia

3.C-a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese ***Me këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykime.*** ***Si e vlerëson kolegji aftësinë e ndihmësmagjistratit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese?***

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shume e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*				

4. Vlerësimi i aftësive personale dhe i angazhimit profesional

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistratit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e gjykatës, gatishmëria e tij për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A-a Komunikimi i qartë dhe transparent

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, publikun (nëse është rasti), subjektet e tjera dhe të tretët.

Si e vlerëson kolegji aftësinë e ndihmësmagjistratit për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

4.A-b Respektimi i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave personale

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të treguar kujdes për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me informacionit dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit.

Si e vlerëson kolegji respektimin e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale nga ndihmësmagjistrati?

I dobët ☐	Mesatar ☐	I lartë ☐

Shpjegime: *(Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

Plotësuar nga anëtarët e kolegjit:

Emër	Mbiemër	Nënshkrimi
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

Dorëzuar në datën
Marrë në dorëzim nga kryetari Emër Mbiemër Nënshkrimi

Lidhja III

**FORMULAR I MENDIMIT TË KRYETARIT
PËR VLERËSIMIN E NDIHMËSMAGJISTRATIT
NË GJYKATËN E LARTË**

Për periudhën e vlerësimit 20__–20 ___

TË DHËNAT E NDIHMËSMAGJISTRATIT

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Adresa e *email*-it zyrtar:

Adresa e *email*-it privat:

Numër telefoni:

Gjykata:

Funksioni:

Formulari i mendimit (më poshtë "formulari") të kryetarit dhe hapat për plotësimin e tij

1. Ky formular përmban mendimin dhe vlerësimin që kryetari jep për ndihmësmagjistratin gjatë periudhës së vlerësimit etik dhe profesional.

2. Ky formular është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 77, shkronja "ç" dhe "d", të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (ligji për statusin).

3. Formulari plotësohet nga kryetari i Gjykatës, në zbatim të nenit 86 të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (ligji për statusin).

4. Në rast se në momentin e fillimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, kompetencat e kryetarit ushtrohen nga zëvendëskryetari, në referim të parashikimeve të nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", formulari i mendimit të kryetarit plotësohet nga zëvendëskryetari.

5. Kryetari, brenda 2 muajve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional, pasi ka administruar formularin e vetëvlerësimit të ndihmësmagjistratit dhe atë të mendimit të kolegjit, plotëson formularin e mendimit të kryetarit dhe ia dërgon atë Këshillit së bashku me aktet e tjera të vlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 88 të ligjit për statusin.

Vlerësimi i kryetarit, në zbatim të nenit 87, pika 1, të ligjit për statusin, bazohet në standardet e mëposhtme:

6. Kryetari i Gjykatës nuk jep mendim vetëm për kriterin e aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit. Nëse kryetari është anëtar i kolegjit ku ndihmësmagjistratit ka ushtruar funksionin, mendimi për aftësitë profesionale jepet prej tij në cilësinë e anëtarit të kolegjit, në formularin e mendimit të kolegjit.

7. Në mendimin e kryetarit përshkruhet dhe vlerësohet veprimtaria e ndihmësmagjistratit, sipas tri grup-kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, konkretisht për:

- aftësitë organizative;

- etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

8. Për kriterin e "aftësive organizative", kryetari jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë (treguesi sasior), nëpërmjet:

a) treguesit sasiorë në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore;

b) rendimentit të përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore;

ii. Aftësinë për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara (treguesi i shpejtësisë), në drejtim të:

a) respektimit të standardit minimal kohor.

iii. Metodologjisë së punës (aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës), në drejtim të:

a) aftësisë për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor;

b) aftësisë për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relatim, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi për shkak të kërkesave procedurale;

c) rregullshmërisë, saktësisë e plotësisë së dosjes gjyqësore.

9. Për kriterin e "etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, kryetari jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Etikën në punë, e vlerësuar nëpërmjet angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion;

ii. Integritetin e ndihmësmagjistratit, i vlerësuar nëpërmjet shmangies së shfaqjes së pahijshme dhe transmetimit të vlerave personale dhe profesionale si nderi dhe dinjiteti;

iii. Paanësinë në funksion, e vlerësuar nëpërmjet përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese dhe numrit "tejet të lartë" të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari.

10. Për kriterin "aftësitë personale dhe angazhimi profesional", kolegji jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Aftësitë e komunikimit, nëpërmjet:

a) komunikimit të qartë dhe transparent;

b) respektimit të konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

ii. Aftësitë për të bashkëpunuar, nëpërmjet:

a) gatishmërisë dhe shkallës së komunikimit dhe të bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës profesionale me ta;

b) gatishmërisë dhe kontributit për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të Gjykatës;

c) aftësisë për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje.

iii. Gatishmërisë për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

11. Mendimi i kryetarit jepet duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në nenin 78 të ligjit për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi. Kryetari jep shpjegime dhe argumenton mendimin e tij.

12. Kryetari vlerëson aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit duke përzgjedhur shkallën e aftësisë për çdo tregues vlerësimi, mbi bazën e analizës së të dhënave statistikore të veprimtarisë së ndihmësmagjistratit, duke i krahasuar ato me treguesit mesatarë statistikorë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, në të njëjtën periudhë kohore.

13. Vlerësimi për etikën, integritetin dhe paanësinë jepet bazuar në prezumimin se ndihmësmagjistrati i ka këto cilësi. Kryetari parashtron dhe jep mendim për problematika të shfaqura nga ndihmësmagjistrati, të tilla që duhet të merren parasysh në vlerësim.

14. Mendimi dhe vlerësimi për treguesin e "gatishmërisë për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë", bëhet nga kryetari, në rastet kur ai është në dijeni të angazhimit të ndihmësmagjistratit apo kur ky angazhim ka qenë i iniciuar nga vetë kryetari i Gjykatës së Lartë.

VLERËSIMI KUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

2. Vlerësimi i aftësive organizative të ndihmësmagjistratit

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë, menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e çështjeve që ai përgatit në funksion të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore nga gjykata në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në kolegje. Ky komponent vlerësohet sipas tri aspekteve: sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A-a Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë, referuar standardit sasior të përcaktuar.

Bazuar në të dhënat statistikore, kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit për këtë tregues.

Nën standard ☐	Në standard ☐	Mbi standard ☐

Shpjegime: *(Këtu kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit, duke bërë krahasimin e të dhënave statistikore të ndihmësmagjistratit me treguesin mesatar statistikor sasior të Njësisë së Shërbimit Ligjor.)*

2.A-b Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përfunduar hartimin e dokumenteve ligjore për të gjitha çështjet e caktuara për relatim brenda një viti kalendarik.

Bazuar në të dhënat statistikore, kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit për këtë tregues.

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit, duke bërë krahasimin e të dhënave statistikore të ndihmësmagjistratit me treguesin mesatar statistikor për rendimentin e Njësisë së Shërbimit Ligjor, si dhe bazuar në krahasimin e volumit të punës së përballuar nga ndihmësmagjistrati me atë të ndihmësmagjistratëve e këshilltareve të tjerë të Njësisë.)*

B. Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara

2.B-a Respektimi i standardeve minimale kohore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të respektuar afatet orientuese të miratuara për çdo kategori çështjesh.

Bazuar në të dhënat statistikore të ndihmësmagjistratit, kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së tij për këtë tregues.

E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kryetari jep mendim për shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit, duke bërë krahasimin e të dhënave statistikore të ndihmësmagjistratit me treguesin mesatar statistikor kohor të Njësisë së Shërbimit Ligjor.)*

C. Metodologjia e punës (aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës)

2.C-a Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor. ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit në drejtim të dhënies së ndihmës dhe kontributit aktiv për kryerjen me eficiencë të veprimeve, të tilla si: respektimin e rendit kronologjik të çështjeve për t'u përgatitur në përputhje me afatet ligjore; respektimin e afateve të përcaktuara nga gjyqtari relator/kolegji në kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës; planifikimin dhe zhvillimin e seancave me apo pa pjesëmarrjen e palëve (njoftimin, shpalljen etj.); dokumentimin e vendimeve dhe të veprimeve të tjera procedurale; ndjekjen me rigorozitet të seancave apo diskutimeve për çështjen; ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve nëse kërkohet nga gjyqtari relator.*** ***Si e vlerëson kryetari shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*				
2.C-b Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relatim, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të evidentuar shpejt dhe pa humbur kohë çështje që kërkojnë vëmendje të posaçme, si p.sh.: kërkesat për përshpejtim, pezullim, rastet kur kërkohet apo është e nevojshme përjashtimi i gjyqtarit relator apo raste të tjera të ngjashme, me qëllim evitimin e vonesave në shqyrtimin e çështjeve.*** ***Si e vlerëson kryetari shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*				
2.C-c Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për ruajtjen e renditjes së akteve të dosjes dhe materialeve të tjera dokumentare, në mënyrë të tillë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, si dhe aftësia e tij për të garantuar rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumenteve pjesë e dosjes gjyqësore që krijohet në Gjykatën e Lartë, nga momenti i marrjes së saj deri në dorëzimin në sekretari pas përfundimit të çështjes.*** ***Si e vlerëson kryetari shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*				

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore, në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë

3.A-a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbajtje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetën më shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin.

Si e vlerëson kryetari shkallën angazhimit dhe të përgjegjshmërisë në funksion të ndihmësmagjistratit?

E dobët☐	Nën mesatare☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

3.B Integriteti

3.B-a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të respektuar, miratuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti; aftësia për t'iu përgjigjur pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë, duke vepruar me vetëdije se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja e tij në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Ndihmësmagjistrati duhet të jetë i vetëdijshëm se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Shmangia e shfaqjes së pahijshme është themelore për integritetin. Gjatë punës së tyre si ndihmësmagjistratë ata duhet të përpiqen të shmangin të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme për gjykimin e tyre gjatë hartimit të dokumenteve ligjore për çështjet në gjykim. Ndihmësmagjistratët, megjithëse nuk kryejnë funksione vendimmarrëse por ndihmëse, nuk duhet të mbajnë qëndrime favorizuese ose disfavorizuese, në lidhje me çështjet për të cilat japin kontributin e tyre ndihmës për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë.

Si e vlerëson kryetari aftësinë e ndihmësmagjistratit për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij?
(Prezumohet se ndihmësmagjistrati ka shkallë shumë të lartë integriteti.)

E dobët☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

3.C Paanësia

3.C-a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese ***Me këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykime.*** ***Si e vlerëson kryetari aftësinë e ndihmësmagjistratit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese?***				
E dobët☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shume e lartë☐
Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*				

3.C-b Numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shfaqur paanësi në funksion, referuar raportit të numrit të çështjeve të caktuara ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit dhe numrit të kërkesave të bëra prej tij për heqje dorë, të refuzuara nga kryetari.*** ***Si e vlerëson kryetari numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara për ndihmësmagjistratin?***	
Tejet i lartë ☐	I pakonsiderueshëm ☐
Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*	

4. Vlerësimi i aftësive personale dhe i angazhimit profesional

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistratit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e gjykatës, gatishmëria e tij për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A-a Komunikimi i qartë dhe transparent ***Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, publikun (nëse është rasti), subjektet e tjera dhe të tretët.*** ***Si e vlerëson kryetari aftësinë e ndihmësmagjistratit për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?***				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*				

4.A-b Respektimi i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave personale

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të treguar kujdes për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me informacionit dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit.

Si e vlerëson kryetari aftësinë e ndihmësmagjistratit për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?

I dobët ☐	Mesatar ☐	I lartë ☐

Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B-a Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe disponibiliteti i ndihmësmagjistratit për të bashkëpunuar me kolegët pa cenuar pavarësinë e tij, aftësia për të kontribuar në ngritjen e problemeve, diskutimin dhe propozimet mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit apo ndryshimit të vendimeve njësuese, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale dhe çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë gjyqësore. Vlerësohet gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të ndarë me kolegët përvojën e përftuar në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Si e vlerëson kryetari aftësinë e ndihmësmagjistratit, në lidhje me shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimin me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta?

E dobët ☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

4.B-b Gatishmëria dhe kontributi për të kryer edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të Gjykatës

Në këtë tregues vlerësohet gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të dhënë kontributin e tij edhe në çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, si p.sh., propozime për ndryshime ligjore, përmirësimin e akteve të brendshme rregulluese të gjykatës, organizimin më efecient të administratës gjyqësore etj.

Si e vlerëson kryetari aftësinë e ndihmësmagjistratit për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen?

Shpjegime: *(Kryetari duhet të evidentojë të dhënat mbi kontributin e dhënë nga ndihmësmagjistrati dhe produktet konkrete të përgatitura prej tij në kuadër të kësaj veprimtarie.)*

4.B-c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë bashkëpunues, për të reaguar me efikasitet në rast të shfaqjes së problemeve apo të vështirësive në punë, duke ruajtur qetësinë, etikën dhe duke synuar zgjidhjen e menjëhershme dhe me efektivitet të konflikteve. Vlerësohet, veçanërisht, marrëdhënia korrekte me gjyqtarët, kancelarin dhe administratën gjyqësore.

Si e vlerëson kryetari aftësinë e ndihmësmagjistratit për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje?

E dobët ☐	Nën mesataren☐	Mesatare☐	Mbi mesataren☐	Shumë e lartë☐

Shpjegime: *(Këtu kryetari argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale dhe sjelljes së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)*

4.C Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C-c Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e ndihmësmagjistratit për t'u angazhuar në veprimtari për të përmirësuar sistemin e drejtësisë, me ose pa pagesë, të tilla si: prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrje në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde, me qëllim rritjen e eficiencës; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm, me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Shpjegime: (*Kryetari duhet të evidentojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen e ndihmësmagjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në rastet kur ai është në dijeni të angazhimit apo kur ky angazhim ka qenë i iniciuar nga vetë kryetari i Gjykatës së Lartë.)*

Plotësuar nga kryetari:

Emër Mbiemër Nënshkrimi

VENDIM
Nr. 215, datë 26.5.2021

PËR MIRATIMIN E TABELAVE STANDARDE ME TË DHËNA STATISTIKORE TË NEVOJSHME PËR EFEKT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja "a" të Kushtetutës, nenet 2, 70, pika 3, 74–78, 84–95, 97 dhe 171 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 193, datë 12.5.2021, "Për miratimin e 'Metodologjia e pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë'" dhe nr. 194, datë 12.5.2021, "Për miratimin e 'Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë'", me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, sipas formatit bashkëlidhur vendimit, pjesë përbërëse e tij *(lidhja 1)*.

2. Tabelat hartohen në format shkresor dhe elektronik që kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Naureda Llagami

Lidhja 1

Tabela nr. 1 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt "rekurs", të përfunduara me vendim në dhomë këshillimi nga Gjykata e Lartë, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 2 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt "kërkesa të tjera", të përfunduara me vendim në dhomë këshillimi nga Gjykata e Lartë, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 3 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt "rekurs", të përfunduara me vendim në seancë gjyqësore nga Gjykata e Lartë, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 4 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt "kërkesa të tjera", të përfunduara me vendim në seancë gjyqësore nga Gjykata e Lartë, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 5 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt "rekurs", të përgatitura për relatim në pritje të gjykimit, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 6 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt "kërkesa të tjera", të përgatitura për relatim në pritje të gjykimit, Kolegji Civil/ Penal/ Administrativ.

Tabela nr. 7 - Tabelë përmbledhëse.

Tabela nr. 1

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE, ME OBJEKT "REKURS" TË PËRFUNDUARA NË DHOMË KËSHILLIMI NGA GJYKATA E LARTË PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN _____, PËR VITIN _____
KOLEGJI _____

Nr.	*Nr. akti*	*Datë regjistrimi*	*Datë caktimi/shorti*	*Datë relacioni*	*Afati i përfundimit të relacionit*	*Standard minimal kohor*	*Nr. dhe datë vendimi*	*Relator*

Tabela nr. 2

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE, ME OBJEKT "KËRKESA TË TJERA" TË PËRFUNDUARA ME VENDIM NË DHOMË KËSHILLIMI NGA GJYKATA E LARTË, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN _____,
PËR VITIN _____
KOLEGJI _____

Nr.	*Nr. akti*	*Datë regjistrimi*	*Datë caktimi/shorti*	*Datë relacioni*	*Afati i përfundimit të relacionit*	*Standard minimal kohor*	*Nr. dhe datë vendimi*	*Relator*

Tabela nr. 3

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME OBJEKT "REKURS", TË PËRFUNDUARA ME VENDIM NË SEANCË GJYQËSORE NGA GJYKATA E LARTË, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN_____, PËR VITIN _____
KOLEGJI _____

Nr.	*Nr. akti*	*Datë regjistrimi*	*Datë caktimi/shorti*	*Datë relacioni*	*Afati i përfundimit të relacionit*	*Standard minimal kohor*	*Nr. dhe datë vendimi*	*Relator*

Tabela nr. 4

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME OBJEKT "KËRKESA TË TJERA", TË PËRFUNDUARA ME VENDIM NË SEANCË GJYQËSORE NGA GJYKATA E LARTË, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN_____,
PËR VITIN _____
KOLEGJI _____

Nr.	*Nr. akti*	*Datë regjistrimi*	*Datë caktimi/shorti*	*Datë relacioni*	*Afati i përfundimit të relacionit*	*Standard minimal kohor*	*Nr. dhe datë vendimi*	*Relator*

PËRMBAJTJA E TABELAVE NR. 1, NR. 2, NR. 3 DHE NR. 4

Tabelat nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 plotësohen me të dhënat statistikore, sipas rubrikave për çdo vit kalendarik të periudhës së vlerësimit dhe për çdo Kolegj të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ndihmësmagjistrati ka ushtruar veprimtarinë këshilluese dhe ndihmëse.

Lidhur me përmbajtjen e tabelave për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve, sipas kolegjeve e ritit procedural të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, në secilën tabelë, për çdo çështje, plotësohen këto të dhëna:

"Nr." është numri rendor.

"Nr. akti" është numri i aktit. Me qëllim lehtësimin e aksesit në dosje në këtë rubrikë duhet të plotësohet numri i plotë i regjistrit, duke vendosur numrin e regjistrit fizik dhe numrin e regjistrit elektronik të çështjes: p.sh., nr. regj fizik/nr. regj elektronik.

"Datë regjistrimi" është data në të cilën çështja është regjistruar në gjykatë.

"Datë caktimi/shorti" është data e caktimit të çështjes ose data e shortit është data e shortimit, elektronik ose manual, në raste të caktuara, për caktimin e ndihmësmagjistratin. Nëse çështja është caktuar më parë pranë një ndihmësmagjistrati tjetër dhe më pas, për arsye të ndryshme ndihmësmagjistrati ndryshohet, do të shënohet data e shortimit për caktimin e ndihmësmagjistratit që vlerësohet, i cili ka përfunduar çështjen.

"Datë relacioni" është data e përfundimit të dokumentit ligjor, analizë/opinion ... etj. nga ndihmësmagjistrati.

"Afati i përfundimit të relacionit" është periudha kohore nga data e marrjes së çështjes për përgatitjen e dokumentit ligjor (data e shortit për caktimin e ndihmësmagjistratit) deri në datën e përfundimit të dokumentit ligjor, i shprehur në ditë.

Krahasuar me "*Standardin minimal kohor*". Në këtë kolonë bëhet shënimi nëse afati i përfundimit të dokumentit ligjor është brenda standardit minimal kohor të përcaktuar nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve ose kryetari i Gjykatës, duke bërë shënimin (+) ose (–) në rastet kur ky afat është respektuar ose tejkaluar.

Numër dhe datë vendimi (numri i vendimit sipas regjistrit manual të çështjeve dhe numri i prodhuar nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve: p.sh., nr. regj. fizik/nr. regj. Elektronik, si dhe data e shpalljes së vendimit nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë.

Relator. Kolona "Relator" do të plotësohet duke shënuar emrin e gjyqtarit relator të caktuar për gjykimin e çështjes.

Tabela nr. 5

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME OBJEKT "REKURS", TË PËRGATITURA PËR RELATIM NË PRITJE TË GJYKIMIT, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN_____,
PËR VITIN _____
KOLEGJI _____

Nr.	*Nr. akti*	*Datë regjistrimi*	*Datë caktimi/shorti*	*Datë relacioni*	*Afati i përfundimit të relacionit*	*Standard minimal kohor*	*Relator*

Tabela nr. 6

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME OBJEKT "KËRKESA TË TJERA", TË PËRGATITURA PËR RELATIM NË PRITJE TË GJYKIMIT PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN_____,
PËR VITIN _____
KOLEGJI _____

Nr.	*Nr. akti*	*Datë regjistrimi*	*Datë caktimi/shorti*	*Datë relacioni*	*Afati i përfundimit të relacionit*	*Standard minimal kohor*	*Relator*

PËRMBAJTJA E TABELAVE NR. 5 DHE NR. 6

Tabelat nr. 5 dhe nr. 6 plotësohen me të dhënat statistikore, sipas rubrikave për çdo vit kalendarik të periudhës së vlerësimit dhe për çdo Kolegj të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ndihmësmagjistrati ka ushtruar veprimtarinë këshilluese dhe ndihmëse.

Lidhur me përmbajtjen e tabelave për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve, sipas objektit/kategorisë, në secilën tabelë, për çdo çështje, plotësohen këto të dhëna:

"Nr. " është numri rendor.

"Nr. akti" është numri i aktit. Me qëllim lehtësimin e aksesit në dosje në këtë rubrikë duhet të plotësohet numri i plotë i regjistrit, duke vendosur numrin e regjistrit fizik dhe numrin e regjistrit elektronik të çështjes: p.sh. nr. regj. fizik/nr. regj. Elektronik.

"Datë regjistrimi" është data në të cilën çështja është regjistruar në gjykatë.

"Datë caktimi/shorti" është data e caktimit të çështjes ose data e shortit është data e shortimit, elektronik ose manual në raste të caktuara, për caktimin e ndihmësmagjistratit. Nëse çështja është caktuar më parë pranë një ndihmësmagjistrati tjetër dhe më pas, për arsye të ndryshme ndihmësmagjistratit ndryshohet, do të shënohet data e shortimit për caktimin e ndihmësmagjistratit që vlerësohet, i cili ka përfunduar çështjen.

"Datë relacioni" është data e përfundimit të dokumentit ligjor, analizë/opinion ... etj., nga ndihmësmagjistrati.

"Afati i përfundimit të relacionit" është periudha kohore nga data e marrjes së çështjes për përgatitjen e dokumentit ligjor (data e shortit për caktimin e ndihmësmagjistratit), deri në datën e përfundimit të dokumentit ligjor, i shprehur në ditë.

Krahasuar me "*Standardin minimal kohor*". Në këtë kolonë bëhet shënimi nëse afati i përfundimit të dokumentit ligjor është brenda

standardit minimal kohor të përcaktuar nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve ose kryetari i Gjykatës, duke bërë shënimin (+) ose (–) në rastet kur ky afat është respektuar ose tejkaluar.

Relator. Kolona "Relator" do të plotësohet duke shënuar emrin e gjyqtarit relator të caktuar për gjykimin e çështjes.

Tabela nr. 7

TABELË PËRMBLEDHËSE ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR SASINË, SHPEJTËSINË, HEQJET DORË NGA ÇËSHTJET, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN _____, PËR VITIN _____

Nr.	***Natyra e çështjeve, sipas ritit të shqyrtimit***	***Çështjet të caktuara për relatim***	***Çështjet të papërfunduara***	***Çështjet e përfunduara***	***Rendimenti***	***Kërkesa për heqje dorë***	***Pranuar***	***Refuzuar***
1	*Rekurs, të përfunduara në dh. këshillimi*							
2	*Kërkesa të tjera, të përfunduara në dh. këshillimi*							
3	*Rekurs, të përfunduara në s. gjyqësore*							
4	*Kërkesa të tjera, të përfunduara në s. gjyqësore*							
5	*Rekurs, të papërfunduara*							
6	*Kërkesa të tjera, të papërfunduara*							
TOTALI								

PËRMBAJTJA E TABELËS PËRMBLEDHËSE

Tabela përmbledhëse e të dhënave statistikore për çdo vit kalendarik, përmban:

Natyra e çështjeve. Kjo kolonë është e plotësuar dhe përmban llojin e çështjeve, sipas ritit të shqyrtimit.

Çështjet të caktuara për relatim. Në këtë kolonë evidentohet numri i çështjeve të regjistruara në gjykatë, që i jepen ndihmësmagjistratit, me qëllim përgatitjen nga ana e tij të dokumentit ligjor (analizë ligjore e çështjes, opinion ligjor dhe/ose material tjetër ndihmës lidhur me të, në funksion të relatimit nga ana e gjyqtarit në kolegj.

Çështjet të papërfunduara. Në këtë kolonë evidentohet numri i çështjeve për të cilat ndihmësmagjistrati ka përgatitur dokumentin ligjor, në funksion të relatimit nga ana e gjyqtarit në Kolegj, por që për arsye që lidhen me ecurinë procedurale të çështjeve në Gjykatën e Lartë, nuk është shqyrtuar ende nga kolegji përkatës.

Çështjet të përfunduara. Në këtë kolonë evidentohet numri i çështjeve për të cilat kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë është shprehur me vendim, në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore.

Rendimenti. Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore është raporti midis çështjeve të përgatitura për shqyrtim (të përfunduara + të papërfunduara) pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve të caktuara për përgatitjen e dokumentit ligjor, brenda një viti kalendarik. Ky tregues llogaritet automatikisht pas hedhjes së të dhënave.

Kërkesa për heqje dorë. Në këtë kolonë evidentohet numri i kërkesave për heqje dorë të paraqitura nga ndihmësmagjistratit.

Pranuar. Në këtë kolonë evidentohet numri i kërkesave për heqje dorë, të cilat janë pranuar nga kryetari.

Refuzuar. Në këtë kolonë evidentohet numri i kërkesave për heqje dorë, të cilat janë refuzuar nga kryetari.

VENDIM
Nr. 117, datë 4.5.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "WTS – ENERGJI" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 16, SERIA PV04P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 39, DATË 22.7.2004, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s, MODIFIKUAR ME VENDIMIN E ERE-s NR. 26, DATË 9.4.2009 DHE VENDIMIN NR. 115, DATË 7.10.2013

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 10, pika 3 dhe të nenit 15, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 64/2 prot., datë 28.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'WTS – ENERGJI' sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.7.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, modifikuar me vendimin e ERE-s nr. 26, datë 9.4.2009, dhe vendimin nr. 115, datë 7.10.2013",

konstatoi se:

- Shoqëria "WTS – ENERGJI" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 617 prot., datë 22.4.2021, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC "Tamarë".

- Kërkesa për modifikim vjen për arsye se gjatë rikonstruksionit HEC "Tamarë", ka pësuar rritje të kapacitetit nga 750 kw, në 1500 kw.

- Me vendimin nr. 39, datë 22.7.2004, shoqëria është pajisur me licencë prodhimi edhe për HEC "Tamarë". Më tej, me vendimin nr. 115, datë 7.10.2013, "Për modifikimin e licencës së shoqërisë 'WTS – ENERGJI' sh.p.k., me nr. 16, seria PV04P, "Për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC 'Tamarë'", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 22.7.2004, kapaciteti i instaluar i HEC "Tamarë" nga 150 kw është rritur në 750 kw.

- HEC "Tamarë" është privatizuar në vitin 2003 nëpërmjet "Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme" të objektit dhe truallit hidrocentrali "Tamarë", Malësi e Madhe, nr. 2236 rep., nr. 193 kol., datë 11.7.2003.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për modifikimin e licencës pranë Raiffeisen Bank në datën 22.4.2021, në vlerën 50 000 lekë, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria "WTS – Energji" sh.p.k., në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", rezulton i plotësuar kryesisht si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

- Neni 9, pika 1, germa "a" (të dhënat për aplikim), germa "b" (të dhëna identifikuese për aplikuesit), plotësuar;

- Neni 15, pika 4:

- germa "a", një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës, plotësuar;

- germa "e", të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE, plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 1, germa "c" (të dhëna për aplikuesin):

Nenin 15, pika 4,

- germa "b", vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës, pa plotësuar;

- germa "c", miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera, plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë:

- miratimin e pikës së lidhjes për HEC "Tamarë" me kapacitetin 1500 kw;

- konfirmimin e basenit ujëmbledhës Drin–Bunë, për vlefshmërinë ose jo të këtij autorizimi edhe për kapacitetin 1500 kw ose një miratim të ri në vijim të rritjes së kapacitetit të HEC "Tamarë", duke qenë se autorizimi i posaçëm për përdorim të burimit ujor është lëshuar në vitin 2010;

- Vlefshmërinë e lejes së mjedisit, duke qenë se shkresa e Ministrisë së Mjedisit me nr. 407/3 prot., datë 13.1.2005, "Mbi operimin e disa hidrocentraleve ekzistuese", e cila citon se: "Ndërhyrjet e paraqitura për rehabilitimin e disave prej tyre...konsistojnë në ndërhyrje minimale (ngritje dige deri në 20 cm) dhe për pasojë nuk konsiderohen me ndikime domethënëse në mjedis.", mban datë shumë të hershme dhe nuk mund të konsiderohet e vlefshme për këtë aplikim;

- germa "d", ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi, pa plotësuar; do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë ato brenda afateve që përcakton "Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "WTS – ENERGJI" sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.7.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, modifikuar me vendimin e ERE-s nr. 26, datë 9.4.2009 dhe vendimin nr. 115, datë 7.10.2013, për shkak të rritjes së kapacitetit nga 750 kw në 1500 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 118, datë 4.5.2021

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OSSH SHA, LIDHUR ME RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 61, DATË 25.1.2021

Në mbështetje të nenit 16, nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të "Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 20.12.2019; të neneve 15, pika 1 dhe 16, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 92, të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 67/1 prot., datë 3.5.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 61, datë 25.1.2021,

konstatoi se:

-Shoqëria OSSH sh.a., nëpërmjet shkresës me nr. 7997, datë 21.10.2020, i ka kërkuar ERE-s ndryshimin e kësaj rregullore duke përfshirë në të tipologjitë e konstatimeve në terren, që nuk janë të parashikuara në rregullore, si më poshtë:

- ndërhyrje në sistemin e matjes (makineri e hapur) në bokse kolektive;

- përdorues rrjeti me linjë të dytë në bokse kolektive;
- përdorues rrjeti me neuter të këputur në bokse kolektive;
- përdorues rrjeti me faza të shuntuara në bokse kolektive;
- përdorues të lidhur në rrjet pa kontratë.
- Në zbatim të nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE përcaktohet si autoriteti përgjegjës për miratimin e "Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike".
- Gjithashtu, shoqëria OSSH sh.a., me shkresën nr. 7997, datë 21.10.2020, i ka kërkuar ERE-s ndryshimin e afateve të parashikuara në nenin 10, të rregullores, si më poshtë:

Afati i lëshimit të faturës, në kushtet kur OSSH sh.a. punon me sistem faturimi me cikël 30-ditor dhe printimi është i tillë, afati lidhur me lëshimin e faturës të jetë brenda 30 ditëve ose ciklit mujor të lexim/faturimit, si dhe njoftimi i furnizuesit të bëhet nga momenti i emetimit të faturës përkatëse, si momenti që zyrtarizon shkeljen.

- ERE, me vendimin nr. 61, date 25.2.2021, ka miratuar fillimin e procedurës për një ndryshim në "Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike", vetëm për një ndryshim në nenin 10, duke përjashtuar pjesën tjetër të kërkesës për ndryshimin në nenin 2 të rregullores, me arsyetimin që ndryshimet e propozuara në nenin 2, të rregullores, nuk argumentohen nga OSSH sh.a. dhe nuk saktësojnë kategoritë e shkaktuesve të dëmit të cilët duhen përfshirë.
- Në vijim, shoqëria OSSH sh.a., me anë të shkresës nr. 3154 prot., datë 31.3.2021, ka kërkuar dhe një herë rishikimin e fillimit të procedurës për një ndryshim në "Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshëm në sistemin e matjes së energjisë elektrike" miratuar me vendimin nr. 61, datë 25.2.2021.
- Për qëllime të analizës së kësaj praktike dhe argumentimeve, sa i përket efekteve reale të supozuara nga OSSH sh.a., reflektuar në kërkesën si më lart, si dhe në përputhje me kërkesat e nenit 92, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 25.2.2021, "Për fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në 'Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike'", me 30 ditë.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 4472, datë 28.5.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtim rruge, unazë (ish-kundërajrori)", Korçë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Korçë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"; bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.03.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së

masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, si dhe bazuar në shkresën nr. 52/8 prot., datë 5.3.2021, të Bashkisë Korçë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16,500 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Etjen Xhafaj

Lista paraprake e shpronësimit të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim rruge, unazë (ish-kundërajrori)"

Nr.	Emër/Atësia/Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale Tokë "arë" (m^2)	Sip. e shpronësimit Tokë "arë" (m^2)	Çmimi Tokë "arë" (m^2)	Vlera e tokës truall (lekë)	Vlera totale/ lekë	Shënime
1	Pandeli Arqile Tarusha	8563	2/210	1000	165	100	16,500	16,500	Me urdhrin nr. 36, datë 13.3.2018, të regjistruesit, në zbatim të nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, vendoset kufizim deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor
	Vlera totale e shpronësimit							**16,500**	

Shënime.

Vlerësimi i tokës arë është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" dhe në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 83
Datë: 2021/06/01 14:12:03
a73a2f90-acdd-4b78-8bb3-389ba3387a0c

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë